

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA-UT (2024-2028)



Miratuar me Vendimin e Dekanatit

Nr. 61 datë 03.10.2024



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA-UT (2024-2028)

Vizioni

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës, një komunitet i mobilizuar sa humanist aq edhe shoqëror, synon të kontribuojë në formimin cilësor të studentëve në gjuhë dhe kultura të huaja, në krijimin e mirëkuptimit të ndërsjellë, të harmonisë shoqërore dhe ndjenjës së qytetarisë globale të shekullit XXI, të shërbejë si urë komunikimi për çështjet me interes kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke krijuar një hapje dhe ndjeshmëri ndaj kulturave të ndryshme në fushën e gjuhëve, letërsisë dhe komunikimit.

Misioni

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës synon përsosmërinë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor duke zhvilluar një mjedis akademik që nxit mirëkuptimin, ndërveprimin ndërkulturor në shoqëri dhe promovon shkëmbime gjuhësore, akademike dhe kulturore.

Prioritete në misionin e tij:

Të ofrojë programe studimi cilësore në gjuhë dhe kultura të huaja për t'i bërë studentët, profesionistë të së ardhmes, të kuptojnë sfidat e botës së sotme dhe për t'u bërë paraprirës të zgjidhjeve për të ardhmen.

Të rrisë shanset për formim dhe punësim të studentëve përmes programeve sfiduese, metodologjive inovative digjitale në mësimdhënie, kërkimit shkencor pluridisiplinar, fuqizimit të lidhjes me aktorë të tregut të punës dhe ndërkombëtarizimit.

Parimet dhe vlerat

- Gjithëpërfshirje
- Ndërkombëtarizim
- Inovacion
- Integritet

Personeli akademik dhe studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja përbëjnë potencialin më të rëndësishëm i cili duhet vlerësuar dhe promovuar duke u mbështetur në punën mësimore, kërkimore-shkencore dhe ushtrimin e lirisë akademike. Kjo platformë do të vihet në zbatim nëpërmjet bashkëpunimit efektiv, transparencës dhe vendimmarrjes kolegjiale.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Inovacion në mësimdhënie, kërkim, zhvillim

- Formimi i vazhduar i të gjithë stafit dhe studentëve drejt inovacionit dhe frymës sipërmarrëse, në një frymë ndërdisiplinore dhe specializimit/mbështetjes së të interesuarve, nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive të mëposhtme:

- Atelier të dedikuara për Design Thinking.
- Start-up Weekend.
- Programe të zhvilluara në bashkëpunim me dhomat e Tregtisë.
- Krijim i rrjetit të pedagogëve novatorë.
- Mbështetje e projekteve ndërdisiplinore.

- Zhvillim i inkubatorit për të rritur lidhjet me botën socio-ekonomike dhe për të integruar pritshmëritë e qytetarëve (përfshirë stafin dhe studentët) në proceset e zbulimit, përpunimit dhe transferimit të inovacioneve që rezultojnë nga puna kërkimore:

- Zhvillimi i programeve të mentorimit dhe këshillimit ku realizohen workshope, trajnime, evente rrjetëzimi dhe prezantimi.
- Krijimi i një infrastrukture për të ndihmuar për aplikimin në projektet e bashkëpunimit shkencor të studentëve dhe doktorantëve që aplikojnë në programe të financimit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe start-up-eve;



OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Inovacion në mësimdhënie, kërkim, zhvillim

- Kontribut në transferimin e njohurive drejt shoqërisë shqiptare dhe forcimi i kapaciteteve për të inovuar, veçanërisht falë aftësive të ofruara për brezat e ardhshëm:

- Zhvillim i projekteve të përgjegjësisë sociale, që promovojnë gjuhët dhe kulturat e që përfshijnë komunitetin (shkolla, muze, biblioteka, qendra kulturore).
- Ofrim i programeve të të mësuarit gjatë gjithë jetës për punonjësit lokalë.
- Përfshirje e tematikave të inovacionit në veprimtaritë e grupeve kërkimore/projekteve.
- Evente kulturore dhe shkencore të hapura për publikun e gjerë.

- Eksperimentim dhe zgjerim i mënyrave të reja të bashkëpunimit me institucionet partnere, palët e interesuara socio-ekonomike dhe autoritetet lokale:

- Projekte kërkimore bashkëpunuese që plotësojnë nevojat e tregut në bashkëpunim me profesionistë dhe ekspertë të tregut të punës në programet e ciklit të tretë për nevoja të kërkimit.
- Ofrim i certifikatave të specializuara që plotësojnë nevojat specifike të tregut të punës.
- Organizim i sesioneve të trajnimit in situ në kompani për aftësim praktik në fushat tona studimore.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Inovacion në mësimdhënie, kërkim, zhvillim

- **Fuqizim i mbështetjes për veprimtarinë kërkimore për të arritur standardet më të mira ndërkombëtare:**

- Trajnime për stafin akademik dhe ndihmës-akademik në shërbim të kërkimit.
- Zhvillim i partneriteteve me qendrat/ organizatat kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Mbështetje në studimin e temave të reja dhe motivimin e talenteve të reja (Çmimi Kërkuesi më i mirë i vitit sipas fushave).
- Nxitje dhe mbështetje më e madhe për botimin e teksteve universitare, fjalorëve, monografive.
- Regjistrimi i revistës shkencore FGJH në MAS për t'u rankuar në kategoritë A dhe B, ku synohet të plotësohen dy kritere kryesore: indeksimin e revistës në DOA dhe pajisja e çdo artikulli me DOI

- **Stimulimi i projekteve kërkimore dhe promovimi i kërkimit ndërinstytucional, ndërdisiplinor dhe ndërdepartamentor:**

- Zhvillimi i një sinergjie ndërdepartamentore në lidhje me kërkimin shkencor me qëllim bashkërendimin e projekteve kërkimore ndërdisiplinore, transdisiplinore.
- Krijimi i rrjeteve kërkimore të kërkuesve shkencorë vendas dhe të huaj për të lehtësuar bashkëpunimin.
- Forcimi i lidhjes trajnim-kërkim dhe puna për promovimin e formimit multidisiplinar të doktoraturës përmes veprimtarive shkencore, konferencave, seminareve dhe trajnimeve ndërdisiplinore.
- Mundësi financimi për projekte kërkimore ndërdisiplinore ose grante udhëtimi për studentët që të marrin pjesë në konferenca dhe seminare edhe në disiplina të tjera.

- **Rritja e promovimit të kërkimit, komunikimit të kërkimit dhe përhapjes së kulturës shkencore, veçanërisht në drejtim të politikës së shkencës së hapur dhe të dhënave të hapura (Open science, open data):**

- Trajnime dhe sesione trajnimi mbi shkencën e hapur për të edukuar studiuesit dhe studentët rreth parimeve dhe praktikave të shkencës së hapur.
- Krijimi i Politikave të Shkencës së Hapur dhe mbështetje për botimet me akses të hapur.
- Angazhimi publik dhe evente shkencore në terren për të nxitur besimin dhe bashkëpunimin midis studiuesve dhe publikut.
- Bashkëpunimi me bibliotekat dhe shërbimet e informacionit për të ofruar infrastrukurë dhe mbështetje për iniciativat e hapura shkencore.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Përsosmëri në kërkim shkencor

- Përcaktimi i një politike dhe i orientimeve strategjike në shërbim të kërkimit, për nxitjen e një mjedisi kërkimor produktiv dhe inovativ:

- Zhvillimi i kërkimit shkencor duke hulumtuar tematika të reja dhe të nevojshme për zgjidhjen e problematikave të mësimdhënies-nxënies së gjuhëve të huaja në arsimin parauniversitar.
- Zhvillimi i veprimtarive shkencore kërkues-studentë veçanërisht me karakter ndërdisiplinor, në lidhje me zhvillimin e dimensionit social në kërkim shkencor dhe mësimdhënie.
- Zhvillimi i projekteve kërkimore që adresojnë nevojat e komunitetit dhe kontribuojnë në drejtësinë sociale dhe mjedisore duke u mbështetur në një bashkëpunim me organizatat e komunitetit, OJQ-të dhe qeveritë lokale për të identifikuar prioritetet e kërkimit dhe bashkë-hartimin e projekteve që kanë ndikim në botën reale.
- Zbatimi i politikave dhe programeve që promovojnë diversitetin, barazinë dhe përfshirjen brenda komunitetit akademik.
- Sigurimi i burimeve dhe shërbimeve mbështetëse për studentët, fakultetin dhe stafin e pakicave të nënpërfaqësuar për të siguruar pjesëmarrjen dhe suksesin e tyre të plotë në mësimdhënie dhe kërkime.
- Trajnime dhe seminare mbi praktikën e kërkimit etik, duke përfshirë përdorimin e përgjegjshëm të të dhënave, shqyrtimin e implikimeve etike dhe angazhimin me komunitete të ndryshme.
- Nxitja e bashkëpunimeve midis studiuesve në shkencat humane me shkencat natyrore dhe shkencat sociale dhe për të kuptuar më mirë dimensionet sociale të kërkimit shkencor dhe përparimet teknologjike.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

Promovimi i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

-Realizimi i fushatave promovuese dhe të marketingut nëpërmjet:

- Përdorimit të medieve sociale (Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter) për të synuar studentët e mundshëm me anë të njoftimeve të programeve gjuhësore.
- Optimizimit të mëtejshëm të faqes së internetit të Fakultetit për publikimin e rregullt të artikujve (dëshmi studentësh dhe informacione mbi programet mësimore).
- Krijimit të broshurave dhe materialeve tërheqëse që paraqesin programet e studimit, mundësitë e karrierës dhe përftimet e studimit në FGjH.

- Prodhimit të videove promovuese që nxjerrin në pah historitë e suksesit të studentëve, programet, ngjarjet kulturore dhe mundësitë ndërkombëtare.
- Organizimit të ditëve të hapura për të lejuar studentët e ardhshëm dhe prindërit e tyre të vizitojnë fakultetin, të takojnë pedagogët dhe të zbulojnë programet.
- Marrjes pjesë në panaire arsimore dhe panaire universitare për të promovuar programet e studimit për një audiencë të gjerë.
- Krijimi dhe bashkërendimi i një agjende me departamentet për promovimin e FGjH-së në mediet pamore.

- Përdorimit të teknologjive për të zhvilluar kurse online dhe MOOC për të arritur një audiencë më të gjerë dhe për të ofruar fleksibilitet për studentët.
- Organizimit të webinarëve për t'iu përgjigjur pyetjeve të studentëve të ardhshëm dhe për të prezantuar programet.
- Zhvillimit të mëtejshëm të partneriteteve më sistemin parauniversitar dhe biznesin, agjencitë qeveritare, institucionet kërkimore, përfaqësi diplomatike dhe universitetet e tjera për zgjerimin e ofertës për studentët (trajnime, stazhe, mundësi punësimi, sponsorizime etj.).
- Krijimi i programeve të mentorimit midis studentëve të fakultetit dhe nxënësve të shkollave të mesme për orientimin e tyre universitar;



OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

Promovimi i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

-Zbatimi i një politike të markës në vend:

- Aktivitete në bashkëpunim me Alumnin për favorizimin e zhvillimit të një fakulteti të hapur duke përdorur ekspertizën dhe përvojën e të diplomuarve për të mentoruar dhe mbështetur anëtarët e fakultetit në fillim të karrierës.*
- Zhvillimi dhe pozicionimi i markës FGJH duke kryer hulumtimin e tregut dhe konsultime me palët e interesuara për të identifikuar pikat e forta, vlerat dhe sipërmarrjen e institucionit në zhvillimet shoqërore, ekonomike, teknologjike, kombëtare dhe ndërkombëtare.*
- Zhvillim i një strategjie marke që artikulon misionin, vizionin dhe mesazhet kryesore të institucionit për ta dalluar atë nga konkurrentët.*

- Faktorizim i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja brenda UT-së dhe jashtë tij nëpërmjet zhvillimit të një politike gjuhësore sipas rekomandimeve të BE-së

- Miratim dhe zbatim i politikës gjuhësore në FGJH dhe propozimi i saj për UT-në.*
- Aplikim për certifikime ndërkombëtare të gjuhëve të huaja.*



OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Orientimi dhe integrimi profesional i studentëve

Ky objektivi synon përmirësimin e aksesit në universitet, orientimin dhe vazhdimin e studimeve të studentëve dhe mbështetjen e profesionalizimit dhe integritit të tyre profesional.

- Zhvillimin e sipërmarrjes studentore, nga niveli universitar deri në atë të Doktoraturës:

- Krijimi i një inkubatori për studentët.
- Zhvillimi i mëtejshëm i platformës ndërvepruese fakultet-biznes.
- Organizimi i konkurseve hekaton për ditët e sipërmarrjes.
- Krijimi i një programi mentorimi nga bizneset për studentët.
- Organizimi i eventeve me studentët si dhe rrjetin Alumni.

- Sigurimi i përmirësimit të vazhdueshëm të informacionit për studentët e ardhshëm, familjet e tyre dhe mësuesit e shkollave të mesme:

- Organizimi i seancave orientuese nëpërmjet zyrës së karrierës.
- Zhvillimi i vazhdueshëm i një programi integrimi për studentët e vitit të parë.
- Krijimi i një guide online për informimin e studentëve për shërbime të strehimit dhe ushqimit të studentëve.

- Përsosja dhe promovimi i programeve të studimit që garantojnë akses më të mirë në arsimin e lartë dhe u përgjigjen çështjeve të mundësive të barabarta:

- Orientimi i programeve drejt modelit studim-punësim për të ndihmuar studentët në një integrim më efikas dhe të shpejtë në tregun e punës.
- Metodologji inovative bashkëkohore duke integruar kërkimin në mësim dhe nëpërmjet zbatimit të projekteve konkrete dhe zhvillimit të aftësive profesionale sipas Kornizës kombëtare të kualifikimeve të profesioneve.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Orientimi dhe integrimi profesional i studentëve

-Mbështetja e ekipeve mësimore/kërkimore në personalizimin e ecurisë së studentit drejt vazhimit të studimeve ose integritit profesional:

- Organizimi i trajnimeve specifike për personelin akademik mbi punën e diferencuar me studentët.
- Vënia në dispozicion e një game të gjerë të materialeve dhe burimeve pedagogjike për ekipin pedagogjik.
- Krijimi i një programi këshillimor të personalizuar nga personeli akademik për studentët dhe krijimi i një çmimi për temën më të mirë kërkimore për studentët e programeve bachelor, master dhe doktoratë.

-Forcimi i lidhjeve me strukturën ekonomike vendase dhe me të diplomuarit (Alumni) për të mbështetur profesionalizimin dhe integrimin profesional të studentëve:

- Organizimi i vizitave, forumeve dhe stazheve në ndërmarrje.
- Integrimi i programeve praktike të përbashkëta me biznesin në formimet universitare.
- Krijimi i programeve të trajnimit të vazhduar të certifikuar në bazë kompetencash (certifikime në menaxhim projektësh, aftësitë digjitale, etj.).
- Zhvillimi i projekteve të përbashkëta me impakt social.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

Mbështetje e jetës shoqërore studentore

- Rritja e mirëqenies gjatë studimit, duke përmirësuar cilësinë e mjedisit të studimit dhe të shërbimit që i ofrohet studentit:

- Mbështetje e mëtejshme e studentëve për menaxhimin e stresit, ankthit, produktivitetin e kohës, etj.*
- Organizim i trajnimeve mbi mirëqenien sociale.*
- Krijim i një këndi sportiv në mjediset e jashtme të fakultetit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.*
- Instalim i këndeve të shkëmbimit të objekteve personale të studentëve (libra, veshje, aksesorë).*
- Instalim i kutive të ideve ku studentët sugjerojnë ose ndajnë propozimet e tyre.*

-Forcimi i politikës së ndihmës dhe mbështetjes për të gjithë komunitetin studentor, veçanërisht studentët me nevoja specifike dhe studentët më vulnerabël:

- Realizim i anketimeve periodike nga shërbimi i psikologëve për identifikimin e nevojave specifike të studentëve.*
- Trajnime për personelin akademik dhe administrativ lidhur me gjithëpërfshirjen dhe metodat e mbështetjes së specializuar.*
- Lehtësim i aksesit në stazhe dhe punësim për studentët me nevoja të veçanta.*

-Dinamizimi i jetës universitare për studentët dhe stafin:

- Aktivitete të vazhdueshme të klubeve studentore me ndikim të hapur për shoqërinë.*
- Aktivitete kulturore dhe sociale duke integruar çështje që lidhen me tranzicionet mjedisore dhe shoqërore.*



OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

Mbështetje e jetës shoqërore studentore

- Përfshirje më e madhe e studentëve në qeverisjen e institucionit:

- Organizim i mbledhjeve të vazhdueshme me anëtarë të Këshillit Studentor.
- Organizim i trajnimeve lidhur me menaxhimin universitar.
- Vijueshmëri e pjesëmarrjes së studentëve në të gjitha strukturat e përfaqësimit të tyre.
- Bashkë-menaxhim i projekteve të caktuara të Fakultetit : p.sh., evente kulturore, shkencore, diplomimi, etj.

- Forcimi i politikës në lidhje me angazhimin e studentëve dhe mbështetjen dhe promovimin e nismave studentore, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe çështje të tjera kryesore shoqërore:

- Thirrje të hapura për projekte që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe çështje të tjera kryesore shoqërore.
- Trajnime dhe seminare për sensibilizimin e studentëve mbi zhvillimin e qëndrueshëm ose çështje të tjera me interes për zhvillimin e shoqërisë.
- Organizim i konkurseve me tema që lidhen me shoqërinë dhe krijimi i çmimit "Studenti më i angazhuar".
- Organizim i klasave të hapura ku zhvillohen projekte të përbashkëta mësimore me kolegë dhe studentë të huaj.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

Mbështetje e jetës shoqërore studentore

- Përfshirje më e madhe e sportit në të gjitha dimensionet e tij në FGJH:

- Krijimi i një agjende të veprimtarive sportive.
- Vazhdimi i kursit ekstrakurrikular të modulit Sporte.
- Zhvillimi i partneriteteve me klubet dhe federatat sportive për projekte të përbashkëta.
- Promovimi i sporteve të reja, alternative dhe gjithëpërfshirëse.

- Mbështetje e politikës kulturore për studentët, sigurimi i qëndrueshmërisë së veprimeve për të lejuar një shikueshmëri më të madhe të tyre:

- Partneritete me institucione kulturore.
- Shpërndarje e veprimtarive kulturore në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale.
- Krijimi i kalendarit kulturor.

- Veprime për një fakultet gjithëpërfshirës :

- Vendosja e rampave të jashtme.
- Pajisja me një shirit me reliev paralajmërues të shkallëve.
- Pajisja e auditorëve me banka të përshtatura për studentët me aftësi të veçanta.
- Ofrimi i materialeve akademike të personalizuar të cilat mund të kuptohen dhe përdoren lehtësisht nga kategori të ndryshme të studentëve.
- Vlerësimi i nevojave për materiale didaktike dhe planifikimi i buxheteve për sigurimin e tyre sipas kërkesave specifike të personelit akademik dhe studentëve.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 6

Fuqizimi i bashkëpunimit

ndërkombëtar

- Zhvillimi i ndërkombëtarizimit të programeve të studimit :

- Diploma të dyfishta me institucione homologe evropiane.
- Do të vijojë puna për propozimin e dy programeve të përbashkëta (diploma të dyfishta) në nivelin Bachelor në bashkëpunim me Universitetin e Tuscias në Itali dhe Universitetin Kauno Kolegija në Lituani.
- Zhvillimi i moduleve të programeve të studimit online.
- Thellimi i bashkëpunimit me partnerët tanë: Universiteti i Poitiers-së, Universiteti i Bordeaux-së, Universiteti i Caen-it në Francë, Universiteti i Tuscias në Itali, Universiteti Kauno Kolegija në Lituani, Universiteti i Eberswaldes në Gjermani, Universiteti i Veliko Ternovos në Bullgari, etj.

- Zgjerimi i parteriteteve me vendet e programit në kuadër të programit ERASMUS+:

- Marrëveshjet aktuale ndërinstitucionale Erasmus + KA171 që përfshijnë fushat e studimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (aktualisht 44) nëpërmjet të cilave realizohet shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie dhe trajnim, i stafit ndihmës akademik dhe administrativ për trajnim, i studentëve për studime dhe praktikë profesionale, do të vijojnë të zgjerohen duke integruar universitete të reja me programe të njëjta studimi.
- Do të synohet gjithashtu të zgjerohet gjeografia e universiteteve partnere të vendeve të programit të cilat aktualisht janë të shtrira në këto shtete: Austri, Bullgari, Çeki, Francë, Greqi, Gjermani, Holandë, Hungari, Itali, Kroaci, Lituani, Poloni, Rumani, Sllovaki, Spanjë dhe Turqi

- Rritje e mobiliteteve të studentëve, stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ:

- Informim në kohë reale për hapjen e thirrjeve për aplikime në mobilitete Erasmus +. Asistencë nga zyra e MJ në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për aplikim (Studentë & Staf)
- Rritja e numrit të profesorëve të ftuar dhe praktikantëve të huaj në Departamente.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 6

Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

- Rritje e aplikimeve në projekte ndërkombëtare:

- Asistencë nga zyra e projekteve në lidhje me plotësimin e dokumentacionit për aplikim në thirrje të ndryshme për projekte ndërkombëtare
- Trajnime të personelit në shkrimin e tipologjive të projekteve të suksesshme dhe përditësimin në përdorimin e platformave të reja digjitale.
- Prezantimi i gjetjeve në kuadër të kërkimit shkencor/pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare në ditë të veçanta studimore.

- Lidhje me rrjetet ndërkombëtare:

- Promovimi i Fakultetit ndërkombëtarisht, veçanërisht brenda rrjeteve të tilla si Shoqata Evropiane*
- për Arsimin Ndërkombëtar (EAIE), Shoqata e Universiteteve Evropiane (EUA), Shoqata e Edukatorëve Ndërkombëtarë (NAFSA): pozicioni në renditjen ndërkombëtare, prania në rrjetet e ndikimit (U7+) dhe promovimi ndërkombëtar (EAIE, NAFSA);
 - Planifikim dhe regjistrim i universiteteve partnere për ditët e hapura (Open days - hybrid mode);



OBJEKTIVI STRATEGJIK 6

Fuqizimi i bashkëpunimit

ndërkombëtar

- Eksplorimi i dinamikave te reja të synuara të partneritetit ndërkombëtar:

- Hulumtime dhe kërkime për të gjetur afërsi/ngjashmëri në fusha dhe programe me qëllim vendosjen e partneriteteve të reja me universitetet vendeve kryesore të programit në bazë Departamenti dhe programi studimi.
- Krijimi i një plan veprimi ndërdepartamental për rritjen e partneriteteve ndërinstytucionale.
- Krijimi i një rrjeti rajonal të universiteteve novatore dhe të sigurimit të cilësisë.

- Riafirmimi i solidaritetit të Fakultetit në pritjen e akademikëve dhe studentëve të huaj:

- Krijimi i një agjende të përbashkët me Departamentin në pritjen e kolegëve të huaj.
- Organizim i seancave promovuese online me universitet partnerë.
- Krijimi i një udhëzuesi për studentët e huaj : si mund të vijnë në Shqipëri, si mund të studiojnë në FGjH.
- Organizim i javës së pritjes së studentëve të huaj me bursë Erasmus + 5 (pesë) mujore.
- Zhvillimi i një pritjeje me cilësi të lartë në fakultet për ndërkombëtarët në kohë reale dhe në koherencë me objektivat e një fakulteti dinamik dhe të hapur (nën siglën **Mirë se vini në FGjH**)
- Krijimi i "Këndit Erasmus+" në mjediset e FGjH-së.
- Pasurimi i fondit të objekteve me logo FGjH-UT (stilolapsa, USB, bluza etj).

-Monitorimi strategjik i mundësive dhe përfitimeve të ndërsjella të bashkëpunimit ndërkombëtar:

- Pjesëmarrje e vazhdueshme e stafit akademik në tematika të veprimtarive Staff Training Week (STW) me universitetet partnerë.
- Analizë periodike e rezultateve të bashkëpunimit.
- Organizim i Ditës së dëshmimeve të shkëmbimeve Erasmus + (staf+studentë).



OBJEKTIVI STRATEGJIK 7

Të mësuarit gjatë gjithë jetës për stafin e FGjH-së

-Zgjerimi i mundësive të trajnimit gjatë gjithë jetës dhe nëpërmjet mësimit për të gjithë audiencat si pjesë e një procesi përmirësimi dhe inovacioni pedagogjik:

- Shkëmbime të stafit akademik dhe ndihmësakademik me universitete kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare mbi ndarjen e praktikave më të mira kombëtare apo ndërkombëtare.
- Trajnime në lidhje me zbatimin e një politike proaktive të diversifikimit të burimeve të mësimdhënies/nxënies.

-Sigurimi i koherencës së ndërveprimeve të universitetit me botën socio-ekonomike në lidhje me politika të inovacionit dhe të vlerësimit:

- Trajnime për personelin ndihmësakademik/administrativ.
- Krijimi i partneriteteve me organizata, institucione apo profesionistë të fushës për të marrë këshillat dhe mbështetjen e nevojshme.

- Promovimi dhe lehtësimi i punës së strukturave të Fakultetit nëpërmjet mjeteve të menaxhimit dhe drejtimit:

- Planifikimi strategjik dhe vendosja e qëllimeve që përshkruan misionin, vizionin, qëllimet dhe prioritetet e strukturës përkatëse.
- Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional për të rritur aftësitë e personelit duke ofruar trajnime, seminare etj.
- Nxitja e një kulture të punës në ekip, mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse që vlerëson diversitetin, bashkëpunimin dhe inovacionin.

- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i platformës së zhvillimit të FGjH-së:

- Platforma e zhvillimit të FGjH-së do të jetë objekt monitorimi dhe vlerësimi periodik.
- Çdo objektiv strategjik do të ketë matës të performancës për të monitoruar progresin drejt arritjes së qëllimeve dhe rezultateve strategjike.
- Vlerësime të rregullta do të kryhen për të identifikuar pikat e forta, fushat për përmirësim dhe mundësitë në zhvillim duke marrë parasysh ndryshimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Strategjia e Gjithëpërfshirjes në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja

Miraturar me Vendimin e Dekanatit
Nr. 61 datë 03.10.2024



HYRJE

Gjithëpërfshirja nënkupton ndryshime në përmbajtjen e kurrikulës, qasjet, strukturat dhe strategjitë që bazohen në nevojat specifike të studentëve. Studentët marrin pjesë në klube studentore, qeveri studentore apo aktivitete të ndryshme të organizuara nga Fakulteti pa bërë diferencime mes tyre.

Arsimi gjithëpërfshirës vlerëson diversitetin dhe kontributet unike që sjell çdo student në auditor. Në një Fakultet gjithëpërfshirës, çdo student ndihet i sigurt dhe ka ndjenjën e përkatësisë. Personeli akademik mendohet gjithashtu, të ketë trajnimin, mbështetjen, fleksibilitetin dhe burimet për të inkurajuar dhe për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë studentëve.

Politikat e gjithëpërfshirjes në fakultet adresojë rëndësinë dhe qëllimin e përfshirjes së të gjithë studentëve në jetën dhe veprimtarinë e fakultetit. Politikat e gjithëpërfshirjes synojnë të krijojnë një mjedis ku diversiteti respektohet, ku të gjithë ndjehen të mirëpritur dhe të marrin pjesë aktivisht në procesin akademik. Kjo politikë synon të përcaktojë strategjitë dhe masat konkrete për të siguruar barazinë dhe respektimin e të gjithëve si pjesë e një komuniteti. Nëpërmjet këtij dokumenti, synohet të ndërtohet një mjedis ku çdo student ndihet i përfshirë, i vlerësuar dhe i inkurajuar të kontribuojë në mënyrë të qëndrueshme. Në një epokë ku diversiteti kulturor, etnik, gjinor dhe socio-ekonomik shënon identitetin e shoqërisë së sotme, rëndësia e përfshirjes dhe sfidat në institucionet arsimore bëhen gjithnjë e më të theksuara. Ky dokument nuk është thjesht një serë masash administrative, por një manifest i përbashkët i angazhimit tonë për të krijuar një mjedis të drejtë dhe inkurajues, ku secili student, pa dallim të prejardhjes, bindjeve apo përvojave, ndihet i vlerësuar dhe i përfaqësuar në të gjitha përmasat dhe qëllimet e Fakultetit.

Nëpërmjet kësaj politike, ne synojmë të vendosim themelet e një kornize që inkurajon dhe mbështet një diversitet të gjerë, duke krijuar rrethana ku të gjithë studentët mund të shfaqin potencialin e tyre maksimal dhe të kontribuojnë në një mjedis akademik plot mundësi dhe diversitet.



1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimit të stafit dhe studentëve lidhur me diversitetin:

Objektivi:

- Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i stafit dhe studentëve për të kuptuar, përshkruar dhe promovuar diversitetin në fakultet.

Mënyra e vlerësimit:

- Vlerësimi i kuptimit dhe perceptimit të diversitetit nga stafi dhe studentët përmes sondazheve, trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme sensibilizuese.

Aktivitete:

- Ofrimi i trajnimeve për stafin lidhur me teknologjitë asistuese dhe përmirësimin e mbështetjes së tyre për studentët me aftësi ndryshe.

2. Rritja e përfaqësimit të grupimeve minoritare:

Objektivi:

- Rritja e numrit të studentëve nga grupet etnike dhe minoritetit në të gjitha nivelet e studimit në Fakultet.

Mënyra e vlerësimit:

- Monitorim i përfaqësimit të grupimeve minoritare në aplikimet për pranim dhe regjistrimet në Fakultet.

Aktivitete:

- Organizimi i diteve të hapura për studentët potencialë nga grupet minoritare për të promovuar fakultetin dhe të inkurajojë aplikimin e tyre.
- Organizimi i sesioneve informative dhe workshop-ve për studentët nga grupet minoritare për të shpjeguar procedurat e aplikimit dhe mundësitë që Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron.



3. Përkrahja e iniciativave të studentëve për të promovuar gjithëpërfshirjen:

Objektivi:

- Inkurajimi dhe mbështetja e iniciativave të studentëve për të organizuar aktivitete dhe projekte që promovojnë bashkëpunimin dhe respektin ndërmjet komuniteteve të ndryshme në fakultet.

Mënyra e vlerësimit:

- Monitorim dhe vlerësim i numrit dhe impaktit të iniciativave të studentëve për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në Fakultet.

Aktivitete:

- Krijimi i një fondi konkurrues për studentët që zhvillojnë projekte inovative dhe krijuese që promovojnë gjithëpërfshirjen dhe bashkëpunimin.
- Organizimi i konkurseve vjetore për studentët për të vlerësuar dhe promovuar iniciativat më të mira lidhur me diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në Fakultet.

4. Përmirësimi i shërbimeve për studentët e kategorive të rrezikuara:

Objektivi:

- Zhvillimi dhe rritja e shërbimeve për studentët me kërcënime sociale, financiare ose të tjera.

Mënyra e vlerësimit:

- Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të shërbimeve të reja dhe të përforcuara për studentët e kategorive të rrezikuara përmes sondazheve dhe vlerësimit të përvojës së studentëve.

Aktivitete:



- Krijimi i një qendre mbështetëse për studentët me nevoja të veçanta akademike dhe sociale, duke përfshirë këshillim individual, tutoring dhe ndihmë në punën me studentët.
- Organizimi i aktiviteteve dhe programeve të mentorimit për studentët nga grupet e rrezikuara me qëllim rritjen e suksesit akademik dhe integrimin në Fakultet.

5. Krijimi i politikave dhe procedurave të përkushtuara për luftimin e diskriminimit në bazë të racës, gjinisë, orientimit seksual, besimit, ose aftësive ndryshe:

Objektivi:

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave të qarta që parandalojnë diskriminimin në bazë të racës, gjinisë, orientimit seksual, besimit, ose aftësive ndryshe në të gjitha aspektet e jetës universitare.

Mënyra e vlerësimit:

- Monitorimi i zbatimit të politikave dhe procedurave për raportimin dhe trajtimin e rasteve të dyshimta të diskriminimit.

Aktivite:

- Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për stafin akademik dhe administrativ për të kuptuar dhe zbatuar politikat kundër diskriminimit.
- Krijimi i një platforme online për raportimin e rasteve të diskriminimit dhe trajtimin e tyre nga strukturat përkatëse të Fakultetit.
- Organizimi i diskutimeve të hapura dhe debateve për studentët për të diskutuar rreth çështjeve të drejtësisë sociale dhe të drejtave të njeriut.

6. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete kulturore dhe sociale :

Objektivi:

- Inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në projekte kulturore dhe sociale.

Mënyra e vlerësimit:

- Monitorimi i numrit dhe përfaqësimit të studentëve në projekte kulturore dhe sociale

Aktivite:



- Organizimi i panairit të karrierës dhe seancave të informimit për të lidhur studentët me mundësitë e punës dhe praktikave në fushën e tyre të studimit.
- Krijimi i programeve të mentorimit të sistematizuar për të lidhur studentët me profesionistë dhe ish student,alumni që kanë arritur sukses në fushën e tyre.

7. Zhvillimi i programeve të mentorimit dhe mbështetjes për studentët e rinj dhe ata me nevoja të veçanta akademike:

Objektivi:

- Krijimi i programeve të strukturuar për mentorim dhe mbështetje për studentët e rinj, ata me nevoja të veçanta akademike dhe ata që kanë nevojë për mbështetje shtesë.

Mënyra e vlerësimit:

- Vlerësimi i impaktit të programit të mentorimit dhe mbështetjes në ndihmimin e studentëve për të arritur suksesin akademik dhe për të integruar më mirë në jetën universitare.

Aktivitete:

- Investimi në infrastrukturë të avancuar kompjuterike dhe rrjetit për të përmirësuar aksesin në internet dhe performancën e sistemeve të informacionit në Fakultet.
- Organizimi i trajnimeve dhe seminareve për studentët me qëllim përdorimin e mënyrave inovative dhe të avancuara të teknologjisë për të mbështetur mësimin dhe hulumtimin e tyre.
- Krijimi i një platforme digjitale për të lehtësuar qasjen e studentëve në materiale mësimore, leksione, bibliografi dhe burime të tjera të studimit të cilat mund të ndihmojnë në arritjen e tyre akademike.

8. Krijimi i platformave dhe hapësirave për dialog dhe bashkëpunim të studentëve me njëri-tjetrin:

Objektivi:

- Promovimi i dialogut të hapur dhe bashkëpunimit ndërmjet studentëve për të adresuar çështje si drejtësia sociale dhe diversiteti kulturor.



Mënyra e vlerësimit:

- Monitorimi i pjesëmarrjes së studentëve në platformat dhe iniciativat e dialogut për çështje sociale dhe vlerësimi i impaktit të tyre në kulturën e Fakultetit.

Aktivitete:

- Krijimi i grupeve të punës dhe platformave të ndërsjella për të ndihmuar studentët të formojnë ekipet dhe të zhvillojnë projekte bashkëpunuese.

9. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete të orientuara nga karriera dhe zhvillimi personal-profesional:

Objektivi:

- Inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete dhe programe që promovojnë zhvillimin e aftësive profesionale, si praktikat e punës, mentorimi, dhe punësimi në programet e njohura.

Mënyra e vlerësimit:

- Monitorimi i numrit të studentëve që marrin pjesë në praktika të punës, sesionet e mentorimit, dhe workshop-et e zhvillimit profesional. Vlerësimi i aftësive dhe kompetencave të fituara nga studentët nëpërmjet këtyre programeve.

Aktivitete:

- Organizimi i konkurseve artistike dhe aktiviteteve të artit për të inkurajuar studentët të shfaqin talentet e tyre në artin vizual dhe performues.
- Organizimi i konferencave dhe sesioneve të diskutimit për të adresuar çështje aktuale dhe të rëndësishme shoqërore, duke përfshirë debatet e studentëve dhe prezantimet e hulumtimeve të tyre.

10. Përmirësimi i infrastrukturës për studentët me aftësi ndryshe:

Objektivi:

- Investimi dhe përmirësimi i infrastrukturës në Fakultet për të siguruar aksesin e të gjithë studentëve.

Mënyra e vlerësimit:

- Vlerësimi i frekuentimit të auditorëve dhe aktiviteteve nga studentët me aftësi ndryshe.

Aktivite:


- Vendosja e rampave të jashtme.
- Pajisja me një shirit me reliev paralajmërues të shkallëve.
- Pajisja e auditorëve me banka të përshtatura për studentët me paafësi fizike.
- Sigurimi i pajisjeve dhe teknologjisë asistuese në bibliotekë dhe ambiente të studimit për studentët me nevoja të veçanta.



Plani i veprimit për vitin akademik 2024-2025

Politika e gjithëpërfshirjes në FGJH

Aktivitetet	Organizatorët	Monitoruesit	Afatet
• Trajnim për stafin akademik: Teknologjitë asistuese dhe mbështetese për studentët me aftësi ndryshe.	•Dega e Teknologjisë dhe Informacionit •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik	•Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik • Zyra e Psikologut	Tetor 2024
• Trajnim për studentët: Përdorimi i mënyrave inovative dhe të avancuara të teknologjisë.	•Dega e Teknologjisë dhe Informacionit •Zyra e Psikologut	•Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik •Zyra e Psikologut	Nëntor 2024
• Trajnim për stafin akademik dhe administrativ: Zbatimi i politikave kundër diskriminimit.	•Dega e Teknologjisë dhe Informacionit •Zyra e Psikologut	•Zyra e Psikologut	Dhjetor 2024
• Krijimi i një platforme digjitale për të lehtësuar aksesin e studentëve në materiale mësimore, leksione, bibliografi dhe burime të tjera të studimit të cilat mund të ndihmojnë në arritjet e tyre akademike.	•Dega e Teknologjisë dhe Informacionit •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik	•Administratori	Gjatë gjithë vitit
• Krijimi i një platforme online për raportimin e rasteve të diskriminimit dhe trajtimin e tyre nga strukturat përkatëse të Fakultetit.	•Dega e Teknologjisë dhe Informacionit	•Administratori •Zyra e Psikologut	Gjatë gjithë vitit



<ul style="list-style-type: none"> • Diskutim i hapur me studentët: Të drejtat e njeriut dhe diversiteti në Fakultet. 	<ul style="list-style-type: none"> •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik •Zyra e Psikologut •Këshilli Studentor 	<ul style="list-style-type: none"> •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik •Zyra e Psikologut 	Shkurt 2025
<ul style="list-style-type: none"> • Konkurs për studentët: Promovimi i iniciativave lidhur me diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në Fakultet. 	<ul style="list-style-type: none"> •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik •Zyra e Këshillimit të Karrierës •Këshilli Studentor 	<ul style="list-style-type: none"> •Zyra e Psikologut 	Mars 2025
<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i kurseve të posaçme dhe ndihmuese për realizimin e detyrave të lëndëve mësimore , detyrave të kursit dhe projekteve të ndryshme për studentët me nevoja të veçanta akademike. 	<ul style="list-style-type: none"> •Stafi Akademik 	<ul style="list-style-type: none"> •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik •Zyra e Psikologut 	Gjatë gjithë vitit
<ul style="list-style-type: none"> • Konferencë për studentët: Të ndryshëm por të barabartë! 	<ul style="list-style-type: none"> •Zyra e Psikologut •Këshilli Studentor 	<ul style="list-style-type: none"> •Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik 	Prill 2025
<ul style="list-style-type: none"> • Investimi dhe përmirësimi i infrastrukturës: vendosja e rampave të jashtme, pajisja me një shirit me relief paralajmërues të shkallëve, pajisja e auditorëve me banka të përshtatura për studentët me paaftësi fizike, sigurimi i pajisjeve dhe teknologjisë asistuese në bibliotekë dhe ambiente të studimit për studentët me nevoja të veçanta. 	<ul style="list-style-type: none"> •Administratori 	<ul style="list-style-type: none"> •Administratori 	Gjatë gjithë vitit

